REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ

ZYRA E PROKURIMIT
**KOMUNA E PEJËS**

# Njesia e Prokurimit

Peje, datë, 20.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Pejes, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L- 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.08.2024 me titull Furnizim me Lëndë Djegëse –Dru Nr. të Prok: 635-24-3054-1-1-1 dhe nr i brendeshen 635/24/018/111 nxjerr:

## V E N D I M

***Refuzohet*** – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik AOME " SH.P.K. . të datë 19.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Lëndë Djegëse -Dru Nr. të Prok: 635-24-3054-1-1-1 dhe nr i brendeshen 635/24/018/111 nxjerr:
kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të datës 15.08.2024 te publikuar ne platëformen elektronike të E- Prokurimit .
Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 15.08.2024

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik AOME " SH.P.K. me daten 19.08.2024 , ka parashtruar kërkesen për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Furnizim me Lëndë Djegëse -Dru me Nr. të Prok: 635-24-3054-1-1-1 nr i 635/24/018/111 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 20.08.2024 ka shqyrtuar kërkesen në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kerkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesen tuaj në platformen elektronike të datës: 19.08.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesen tuaj, dhe ka ardhur ne perfundim se njejta eshte e pa bazuar.,

Pretendimet e O,E 1

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat te natyrës se ngjashme në vlerë prej 300.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.

Ndërsa ju në ofertën tuaj nuk keni plotësuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit , qe ka qenë kusht i FDT-së, po ashtu për kontratën me komunën e Obiliqit në vlerë prej 40,000.00euro është kontratë e skaduar si dhe nuk ka ndonjë raport mbi pranim të punëve, vetëm një konstatim, po ashtu edhe kontrata tjetër me KK Obiliqit nuk përputhet vlera me konstatimin si dhe kontrata me komunën e Deçanit është lëshuar një letër konstatimi qe nuk përputhet me FDT si dhe në letër konstatimi nuk ceket vlera e furnizimit të kontratës. në tri vitet e fundit

Po ashtu te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesionalë kërkesa nr.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 2 Vërtetim (dëshmi) të lëshuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit që operatori nuk ka të ngritur ndonjë procedurë nga Drejtoria e Inspekcionit - Sektori i Pylltarisë.

Dëshmia 2 Një vërtetim dëshmi të lëshuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit- Sektori i Pylltarisë. Dhe ju në ofertën e juaj nuk keni prezantuar kësi dokumenti, andaj me keqardhje ju njoftojmë se oferta e juaj është e papërgjegjshme dhe eliminoheni nga ky aktivitet i prokurimit.

***Unë besoj se keni pasur rastin ta lexoni UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK në të cilin janë dhënë sqarime se si duhet të veprojnë autoritetet kontraktuese gjatë procesit të vlerësimit të ofertave:***

10. *Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së Problemi Si të veprohet? Neni i LPP-së Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara ***Mund të kërkohen informata sqaruese 69* .***

Gjatë fazës së vlerësimit të ofertave ju nuk keni vepruar sipas kësaj rregulloreje. Por si do qe të jetë edhe sikur mos të ishin në rregull dy referencat të cilat ju i keni apostrofuar në konstatimin e juaj me rastin e vlerësimit të ofertave ****Ndërsa ju në ofertën tuaj nuk keni plotësuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit , qe ka qenë kusht i FDT-së, po ashtu për kontratën me komunën e Obiliqit në vlerë prej 40,000.00euro është kontratë e skaduar si dhe nuk ka ndonjë raport mbi pranim të punëve, vetëm një konstatim, po ashtu edhe kontrata tjetër me KK Obiliqit nuk përputhet vlera me konstatimin si dhe kontrata me komunën e Deçanit është lëshuar një letër konstatimi qe nuk përputhet me FDT si dhe në letër konstatimi nuk ceket vlera e furnizimit të kontratës*.***

Shuma e kontratave tjera në listën e kontratave të shoqëruara me referenca përkatëse e tejkalon shumën 300,000.00euro të cilën ju e keni kërkuar në FDT.

Pergjegjia nga A,K 1,

Ju njoftojm se ne si A,K kemi vepruar konform FDT pasi siq dihet mire te Kerkesat e pershtateshmeris , KERKESA 1 dhe DESHMIA 1 eshte cekur qarte qe OE si Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara *duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit* ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.

**Aneksi 6. LISTA E KONTRATAVE TË REALIZUARA**

**Ky Aneks është obligativ qe të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë**

| NR. | Titulli i kontratës | Data e nënshkrimit te kontratës | Data e përfundimit te kontratës | Vlera totale e kontratës | Emri i Blerësit | E-maili i Blerësit | Nurmi i telefonit të Blerësit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | |

*(Shto/fshij sipas nevojës)*

**Bashkëngjit:** certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë te Operatoreve Ekonomik.

**Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik** ______________________________

**Vula**________________________________

Ju ne oferten e juaj nuk keni plotesuar kete ANEKS 6 qe ka qene obligative ne FDT-te,andaj me keqardhje ju njoftojm se pretendimet e juaja ne kete pike jane te pa bazuara

Pretendimet e O,E 2

*Po ashtu te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesionalë kërkesa nr.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 2*



*Vërtetim (dëshmi) të lëshuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit që operatori nuk ka të ngritur ndonjë procedurë nga Drejtoria e Inspekcionit - Sektori i Pylltarisë.*

*Dëshmia 2 Një vërtetim dëshmi të lëshuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit- Sektori i Pyllarisë. Dhe ju në ofertën e juaj nuk keni prezantuar kësi dokumenti, andaj me keqardhje ju njoftojmë se oferta e juaj është e papërgjegjshme dhe eliminoheni nga ky aktivitet i prokurimit.*

*Ndërsa sa i përket kërkesës nr.2 Kërkesa 2* ***Vërtetim (dëshmi) të lëshuar nga Komuna e Pejës dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit që operatori nuk ka të ngritur ndonjë procedurë nga Drejtoria e Inspekcionit - Sektori i Pylltarisë.***

Kjo kërkesë është diskriminuese, redukton dhe eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik si dhe diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Është kërkesë të cilën nuk e lëshon asnjë institucion publik në Kosovë.

***Provë***

***Agjencia Pyjore e Kosovës APK me datë 22.07.2020 iu ka dërguar një njoftim me nr.2948 të gjitha komunave në Republikën e Kosovës se Agjencia Pyjore e Kosovës APK nuk do të lëshoj këtë vërtetim për asnjë operatorë ekonomik***

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Neni 72

1. ***Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.***
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

**AK - KOMUNA E PEJËS**, me datë 15.08.2024, përmes platformës elektronike të- e prokurimit merr vendim – 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, qe do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore te LPP- se, dhe rreg. Nr. 001/20222 për PP te cilën do i argumentoj dhe dëshmojë me prova dhe fakte konkrete si ne vazhdim të kësaj KR. **Paragrafi 1 I nenit 7 te LPP** –se e parasheh qartë qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veprojnë ne mënyrë transparente" ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozite, sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për shpërblim me kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsiderate edhe nenin **1 te LLP**-së pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues në Republikën e Kosovës, pasi qe ne si pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit jemi tenderues i përgjegjshëm



dhe me çmimin me të ulët se oferta e operatorit ekonomik e rekomanduar për dhënie të kontratës.

Pergjegjia nga A,K 2,

Sa i perket te kerkesa ne FDT ju si OE keni pase kohe dhe te drejte ligjore te beni kerkes per sqarime sipas pikes 16.1 te FDT-se , apo kerkes per rishqyrtim lidhur me *Kërkesa 2 Vërtetim (dëshmi) të lëshuar nga Komuna e Pejes dhe Komuna përkatëse në vendin e juaj të themelimit që operatori nuk ka të ngritur ndonjë procedur nga Drejtoria e Inspekcionit - Sektori i Pylltaris.*
Ku ju nje gje te tille nuk keni bere , dhe keto kritere te vendosuara jane ne kompetence te AK Komuna e Pejes , ne kordinim me njesin kerkuese. andaj me keqardhje ju njoftojm se pretendimet e juaja ne kete pike jane te pa bazuara

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato qe u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet te dorezohet brenda afatit ligjor .

Me respekt
Milot Gashi
Menaxher i Prokurimit KK Peje

Vendimi i dorëzohet:
1. Një (1) kopje ngarkohet për mes platformës elektronike
2. Një (1) kopje – Arhivës A.K Komuna e Pejës.